



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Proçedura e Konfirmimeve

Sektori i Kërkimit Shkencor, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Rektoratin e UMT-së, mundëson procedurën e konfirmimit të dokumenteve të lëshuara nga fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Dokumentacioni që duhet të depozitohet nga ana e studentit janë, si më poshtë:

1. Diplomë
2. Suplement Diplome
3. Listë e Notave
4. Program Studimi
5. Plan – programet
6. Vërtetim studenti
7. Formularë zyrtarë
8. Informacione mbi karrierën universitare
9. Etj...

Dokumentet mund të depozitohen në variantin original (program i studimit) ose fotokopje. Pasi verifikohet vlefshmëria e tyre nga struktura në fakultetin përkatës, dokumentet më tej firmosen dhe vulosen me vulë të posaçme. Konfirmimi bëhet nga Rektori ose Zv.Rektor përgjegjës i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Kohëzgjatja e procedurës:

- 10 ditë pune për praktika brenda vendit;
- Deri në 20 ditë pune për praktika jashtë vendit.

Shërbimi:

1. Për studentët dhe të diplomuarit në një nga tre fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të cilët bëjnë kërkesë për konfirmim dokumentacioni në Sektorin e Kërkimit Shkencor, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Rektoratin e UMT-së, pagesa është 600 lekë.
2. Për studentët ose të diplomuarit, të cilët ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe bëjnë kërkesë për konfirmim dokumentacioni me anë të shërbimit postar (bashkëlidhur duhet të kenë kërkesën e tyre me shkrim, të firmosur, dhe dokumentacionin e nevojshëm për konfirmim). Për këtë kategori aplikohet tarifa e llogaritur mbi shërbimin e postës së shpejtë EMS të Postës së Shqipërisë për vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, e ndarë në katër zona.
3. Për Institucionet e ndryshme që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe bëjnë kërkesë zyrtare për konfirmim dokumentacioni shkollor të studentëve ose të diplomuarve në një nga tre Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, aplikohet tarifa e llogaritur mbi shërbimin e postës së shpejtë EMS të Postës Shqiptare për vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, e ndarë në katër zona.

**Tabela e tarifave për katër zonat postare:**

Zonat	Shtetet	Tarifa
ZONA I	Bosnie Herzegovinë, Bullgari, Greqi, Kroaci, Maqedoni, Moldavi, Qipro, Rumani, Turqi, Mali i Zi, Serbi, Kosovë.	4.700 lekë
ZONA II	Algjeri, Austri, Belgjikë, Biellrusi, Danimark, Egjipt, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Islandë, Itali, Izrael, Latvi, Lietenshtein, Lituani, Luksemburg, Maltë, Marrok, Mbretëria e Britanisë së Madhe, Monako, Norvegji, Poloni, Portugali, Republika Çeke, Rusi, Siri, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Sudan, Ukrainë, Uzbekistan, Zvicër.	5.200 lekë
ZONA III	Afrika e Jugut, Arabia Saudite, Armenia, Aruba, Azerbaixhan, Emiratet e Bashkuara Arabe, Etiopi, Hong Kong, Indi, Irak, Iran, Japoni, Jemen, Jordani, Kamboxhia, Kanada, Kazakistan, Kenia, Kinë, Kirgjistana, Korea e Jugut, Kuvait, Madagaskar, Malazi, Oman, Pakistan, Senegal, Singapor, Sri-Lanka, Taivan, Tailandë, Tanzani, Togo, Uganda, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zambis, Zimbabue.	7.000 lekë
ZONA IV	Argjentinë, Australi, Bahrain, Bregu i Fildishtë, Brazil, Brunel, Burundi, El Salvador, Filipine, Gabon, Guatemala, Guinea-Bissau, Guinea Ekuatoriale, Guinea, Indonezia, Kamerun, Qatar, Kili, Kolumbia, Kosta Rica, Kuba, Makao, Maldive, Malauis, Mali, Mauritania, Mauricius, Meksikë, Panama, Paraguais, Peru, Porto Riko (USA), Hawaii (USA), Uruguais, Venezuela, Alaska (USA), Xhibuti, Zelandë e Re.	8.000 lekë

Tarifa për çdo konfirmim dokumentacioni arkëtohet përpara fillimit të procedurës. Të interesuarit mund të paraqitet pranë Sektorit të Kërkimit Shkencor, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Rektoratin e UMT-së, për t'u pajisur me mandate - arkëtim.

Pagesa mund të kryhet pranë çdo Banke të nivelit të dytë. Të interesuarit duhet të paraqesin një mjet identifikimi (Kartë identiteti, Pasaportë, Certifikatë) dhe të lënë një fotokopje të saj pranë Sektorit të Kërkimit Shkencor, Promovimit Akademik dhe Komunikimit.

Kontakt:

Për më tepër informacion, lutemi të na kontaktoni në adresën zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë: info@umed.edu.al.

Adresa e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë:
Rruga e Dibrës, Nr. 371, AL1005, Tiranë, Shqipëri.